



**REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**
Ministria e Brendshme



**Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë,
Prezenca në Shqipëri**



**REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**
Ministria e Turizmit,
Kulturës, Rinisë dhe
Sporteve

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

DHE

**MINISTRISË SË BRENDSHME
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

DHE

PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

MBI

**PROMOVIMIN DHE ZBATIMIN E KODIT TË SJELLJES PËR PARANDALIMIN E
SHFRYTËZIMIT SEKSUAL TË FËMIJËVE NË TURIZËM**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (më poshtë referuar si “Memorandumi”) lidhet ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, (me poshtë referuar si “Ministria e Turizmit”), Ministrisë së Brendshme dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri, (më poshtë referuar si Prezenca e OSBE), dhe të tria të referuara si “Palë”;

- Duke qenë se Ministria e Turizmit konsideron si mjaft të rëndësishme mbështetjen e Prezencës së OSBE për promovimin e Kodit Global të Etikës ndërmjet agjencive turistike dhe veçanërisht në lidhje me miratimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm (më poshtë referuar si Kodi i Sjelljes),
- Duke qenë se Ministria e Brendshme ka konsideruar si mjaft të rëndësishme në fokusin e punëve të saj zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm,
- Duke qenë se Prezenca e OSBE, në përputhje me rregullat e OSBE, dëshiron të kontribuojë me asistencë organizative, teknike dhe ligjore, në forcimin e kuadrit rregullator të bashkëpunimit institucional ndërmjet agjencive turistike klientëve dhe institucioneve qeveritare në drejtim të një zhvillimi të sigurt dhe të qëndrueshëm të turizmit,

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit mes palëve për ofrimin e asistencës organizative, teknike e ligjore për Ministrinë e Turizmit, për miratimin e Kodit të Sjelljes, paraqitur në Aneksin e këtij Memorandumi, si pjesë e Kodit Global të Etikës për Operatorët Turistikë, dhe ngritjen e një bordi monitorues me detyrë mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nga operatorët turistikë, (përfshirë agjencitë e udhëtimit dhe hotelierët).

Neni 2. Detyrimet e Palëve

Palët marrin përsipër të përmbushin si vijon:

A. Prezenca e OSBE-së:

1. Do të sigurojë për Ministrinë e Turizmit asistencë organizative, teknike e ligjore për kryerjen e aktiviteteve të saj, me qëllim që të forcohen kapacitetet e agjencive hoteliere dhe të udhëtimit për zbatimin me korrektësi të Kodit të Sjelljes.
2. Do të konsiderojë dhënien e asistencës organizative, teknike dhe ligjore Ministrisë së Turizmit për të:
 - a. Prezantuar Kodin tek operatorët turistikë në Shqipëri
 - b. Ngritur një bord monitorimi për vlerësimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes nga operatorët turistikë në Shqipëri
 - c. Hartuar dhe vënë në zbatim format standarte të raportimit nga operatorët turistike ndaj Bordit;
 - d. Siguruar materialet promovuese të Kodit të Sjelljes të vlefshme për Ministrinë e Turizmit dhe Entin e Turizmit;
 - e. Siguruar trajnimin e anëtarëve të shoqatave hoteliere dhe të udhëtarëve për një kuptim më të mirë të Kodit të Sjelljes dhe detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi për zbatimin e tij;
 - f. Siguruar asistencë tjetër teknike sipas nevojave dhe brenda kapaciteteve;
 - g. Hartuar dhe publikuar materiale për informim publik sipas nevojave;

B Ministria e Turizmit:

- a. Do të përfshijë Kodin Global të Etikës, dhe Kodin e Sjelljes si pjesë e tij në rregulloren e Ministrisë së Turizmit për procedurat e dhënies ose heqjes së licencave dhe rregullat për kualifikimin/standardizimin e shërbimeve të ofruara nga operatorët turistike në Shqipëri;
- b. Do të iniciojë krijimin e grupit të punës për zbatimin e Kodit të Sjelljes, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara shtetërore dhe private;
- c. Do të marrë masat për të siguruar që zbatimi i Kodit të Sjelljes të jetë një instrument pune ndër treguesit e tjerë të performancës së agjencive hoteliere dhe të udhëtarëve që operojnë në Shqipëri;
- d. Do të sigurojë monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes nga agjencitë hoteliere dhe të udhëtimit, si pjesë e Kodit Global të Etikës nëpërmjet strukturave të veta përgjegjëse;
- e. Do të marrë një rol drejtues në promovimin e Kodit të Sjelljes nëpërmjet takimeve konsultuese me aktorët privatë (shoqatat e hotelierëve dhe agjencive të udhëtimit dhe anëtarëve të tyre);
- f. Do të promovojë agjencitë hoteliere dhe të udhëtimit të cilët zbatojnë Kodin e Sjelljes;
- g. Do të ofrojë stafin e kualifikuar për të ngritur kapacitetet institucionale të agjencive hoteliere dhe të udhëtarëve nëpërmjet programeve të trajnimit;

h. Do të bashkëpunojë me institucione të tjera shtetërore si Ministria e Brendshme në shkëmbimin e informacionit lidhur me zbatimin e Kodit të Sjelljes nga operatorët turistike.

C Ministria e Brendshme:

- a. Do të marrë pjesë në Grupin e Punës për zbatimin e Kodit të Sjelljes;
- b. Do të marrë pjesë në Bordin e Monitorimit për vlerësimin e zbatimit të kodit të Sjelljes nga operatorët turistikë;
- c. Do të marrë përsipër detyrime të përbashkëta me Ministrinë e Turizmit për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit për ndëshkimin e shkelësve;
- d. Do të bashkëpunojë me institucione të tjera shtetërore si Ministria e Turizmit në shkëmbimin e informacionit lidhur me zbatimin e Kodit të Drejtimit nga operatorët turistike që e kanë nënshkruar atë;
- e. Do të ofrojë stafin e kualifikuar për të ngritur kapacitetet institucionale të agjensive hoteliere dhe të udhëtimit nëpërmjet programeve të trajnimit;

Neni 3. Organizimi dhe Kryerja e “Shërbimeve”

1. Të tri palët do të sigurojnë mbështetjen e nevojshme menaxheriale, administrative dhe logjistike për kryerjen e “Shërbimeve” të specifikuar në këtë Memorandum.
2. Të tri palët do të sigurojnë personelin e nevojshëm të kualifikuar dhe me eksperiencë për realizimin në mënyrën e duhur të Memorandum dhe do të marrin përsipër përgjegjësitë menaxheriale, ligjore e teknike për të përmbushur detyrimet e tyre përkatëse ashtu siç përcaktohen në këtë Memorandum.

Neni 4. Raportimi dhe Komunikimi

Të gjitha materialet, raportet si dhe të gjitha komunikimet e tjera midis Palëve do të bëhen nga personat e kontaktit të përcaktuara nga palët respektive.

Neni 5. Konfidencialiteti

1. Gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, Palët mund të shkëmbejnë informacione të cilat ata i konsiderojnë konfidenciale. Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis Palëve do të konsiderohen konfidenciale dhe do të menaxhohen nga persona të caktuar nga palët në Memorandum, përveç rasteve kur ato përcaktohen ndryshe me shkrim.
2. Asnjë nga Palët në këtë Memorandum nuk do të veprojë si një Agjent ose Përfaqësues i Palës tjetër.
3. Çdo shkelje e kësaj dispozite do të përbëjë shkak për pezullimin dhe/ose zgjidhjen e këtij Memorandumi.

Neni 6. Ruajtja

1. Ministria e Turizmit dhe Ministria e Brendshme bien dakord të ruajnë të pacenuar Prezencën e OSBE-së nga çdo shkelje nga ana e këtyre Ministrive të çdo ligji të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
2. Palët bien dakord të ruajnë njëri-tjetrin të pacenuar nga ndonjë dëmtim ose humbje që rrjedh direkt ose indirekt si rezultat i ndonjë aktiviteti të Palës tjetër, si pasojë e përmbushjes së këtij Memorandumi.

Neni 7. Dispozita të Përgjithshme dhe Përfundimtare

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të tre palët, dhe do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tij.
2. Ky Memorandum mund të pushohet nga secila prej palëve, në çdo kohë, pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër brenda jo më pak se 30 ditëve kalendarike. Në rast të tillë, Palët që mbeten do të konsultohen për vazhdimësinë e zbatimit të këtij Memorandumi dhe do të nxjerrin së bashku një vendim të përbashkët me shkrim.
3. Çdo ndryshim i Memorandumit do të miratohet me shkrim nga Palët.

Hartuar në Tirane, më 07 Shkurt 2007, në 6 kopje origjinale në Anglisht dhe Shqip, nga të cilat dy kopje origjinale në të dy gjuhët mbahen nga palët kontraktuese respektive. Në raste mosmarrëveshesh, merret në konsideratë versioni në Anglisht.

**Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve**

Për Ministrinë e Brendshme

**BUJAR LESKAJ
MINISTËR**

**IVA ZAJMI
ZËVENDËS MINISTRE**

Për Prezencën e OSBE-së

**AMBASADOR PAVEL VACEK
KRYETAR I PREZENCËS**

1. Ministria e Turizmit dhe Ministria e Brendshme bien dakord të ruajnë të pacenuar Prezencën e OSBE-së nga çdo shkelje nga ana e këtyre Ministrive të çdo ligji të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.
2. Palët bien dakord të ruajnë njëri-tjetrin të pacenuar nga ndonjë dëmtim ose humbje që rrjedh direkt ose indirekt si rezultat i ndonjë aktiviteti të Palës tjetër, si pasojë e përmbushjes së këtij Memorandumi.

Neni 7. Dispozita të Përgjithshme dhe Përfundimtare

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të tre palët, dhe do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tij.
2. Ky Memorandum mund të pushohet nga secila prej palëve, në çdo kohë, pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër brenda jo më pak se 30 ditëve kalendarike. Në rast të tillë, Palët që mbeten do të konsultohen për vazhdimësinë e zbatimit të këtij Memorandumi dhe do të nxjerrin së bashku një vendim të përbashkët me shkrim.
3. Çdo ndryshim i Memorandumit do të miratohet me shkrim nga Palët.

Hartuar në Tirane, më 07 Shkurt 2007, në 6 kopje origjinale në Anglisht dhe Shqip, nga të cilat dy kopje origjinale në të dy gjuhët mbahen nga palët kontraktuese respektive. Në raste mosmarrëveshesh, merret në konsideratë versioni në Anglisht.

**Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve**



**BUJAR LESKAJ
MINISTËR**

Për Ministrinë e Brendshme



**IVA ZAJMI
ZËVENDËS MINISTRE**

Për Prezencën e OSBE-së



**AMBASADOR PAVEL VACEK
KRYETAR I PREZENCËS**

Aneks

Kodi i Sjelljes të Parandalimit të Shfrytëzimit të Fëmijëve në Turizëm

Përshtatja e Kodit të Sjelljes* në angazhimin kundër shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime përfitimi në industrinë e turizmit dhe të udhëtimeve, bëhet nëpërmjet:

Vendosjes së një politike etike të kompanisë lidhur me shfrytëzimin seksual të fëmijëve për qëllime përfitimi. Agjencia e turizmit/udhëtimit të reflektojë në dokument të shkruar të politikës së saj qëndrimin kundër shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime përfitimi.

Trajnimit të personelit të operatorit turistik (agjencisë së udhëtimit/hotelerisë); Personeli i kompanisë, agjentët, stafi i kontraktuar i hotelit/agjencisë së udhëtimit, pavarësisht nga kombësia, sektori, përgjegjësia dhe kushtet e punësimit, duhet të njihen me politikën etike të agjencisë, si pjesë e trajnimit të tyre profesional. Disa punonjës do të trajnohen që të trajnojnë më pas pjesën tjetër të stafit në kompani.

Prezantimit të një pike në kontratat me furnitorët, ku bashkërisht dënohet shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllime përfitimi. Kjo pikë duhet të përcaktojë se kontrata do të anulohet nëse furnitori dhe punonjësit nuk angazhohen për dënimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve për qëllime përfitimi, në ushtrimin e aktivitetit të tyre.

Sigurimit të informacionit udhëtarëve nëpërmjet katalogëve, broshurave, filmave në udhëtim, biletave, faqeve Web etj. Ky informacion do të tërheqë vëmendjen e udhëtarëve në lidhje me problemin, duke bërë të qartë përmbajtjen e Kodit të Sjelljes dhe zotimin e kompanisë së turizmit për zbatimin e Kodit.

Sigurimit të informacionit personave lokalë të kontaktit në vendet e pritëse. Personave të kontaktit (pra personave në vendet e pritëse, me të cilët kompania bashkëpunon pa pasur një kontratë të nënshkruar), t'u ofrohet informacion mbi Kodin e Sjelljes dhe komponentë të zbatimit të tij.

Raportimi Vjetor mbi Zbatimin e Kodit të Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm

Shënim: Ky Kod Sjellje është përshtatur mbi bazën e "Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Sektorin e Udhëtimeve dhe Turizmit" të organizatës ndërkombëtare ECPAT, që mbështetet nga UNICEF dhe Organizata Botërore e Turizmit (www.thecode.org). OSCE/OCCEA në zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ka promovuar dhe mbështetur zbatimin e Kodit të Sjelljes nga 55 shtetet anëtare.